



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2023:166859

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05741448

**K.DH.Shk II.nr.740/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbareme të kreditorit BBA Transport me nr. të biznesit 7631090, me seli në Shkup, Ljubin-Saraj, nr. 17, Maqedoni, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Naim Spahiu me zyre në Prishtinë, kundër debitorit N.T.P “ARQE&IKO” me nr. unik identifikues 810591520 dhe me seli në Prizren, rr. “Jeta e Re” nr. 88, me bazë juridike përmbareme, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës –Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1183/23 të datës 15.01.2024, me datë **28.05.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit BBA Transport, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës –Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr. 1183/23 të datës 15.01.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale të Kosovës –Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar 1183/23 të datës 15.01.2024 në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit të N.T.P “ARQE&IKO” kundër Urdhrit për Përmbareme P.nr.95/23 të dt. 24.04.2023 të Përmbaremesit Privat Mubarak S Shumolli, dhe i njëjti Urdhër për përmbareme është Anuluar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit të procedurës përmbare, vërtetimit të gabuara dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimi të gabuar të së drejtës procedurale, me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1183/23 të datës 15.01.2024, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

**Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori BBA Transport me datën 24.04.2023 ka paraqitur propozimin për përmbare në bazë në bazë të dokumentit të besueshëm të Faturës nr. 17/2022 të datës 02.11.2022 ashtu që është detyruar debitori që në emër të borxhit të papaguar nga fatura e lartcekur, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 1,950.00 EUR (me shkronja: një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë euro) me kamatë ligjore prej 8% deri në përmbushjen definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbare.

Përmbaresi Privat Mubarak S. Shumolli me seli në Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbare të kreditorit me urdhrin përmbare P.nr. 295/23 të dt. 24.04.2023 ka lejuar përmbaremin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor, ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbaremit me arsyetimin se debitori është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe me numër tjetër identifikues, dhe nuk është debitor i faturës kontestuese, andaj janë plotësuar të gjitha kushtet që propozimi për përmbare të refuzohet si i pabazuar. Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje ndaj prapësim.

Gjykata, Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave

të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim: Gjykata vlerëson se dokumenti i besueshëm faturë nr. 17/2022 e datës 02.11.2022 në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përbarim është bashkangjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar tek organi kompetent, e rrjedhimisht propozimi për përbarim është paraqitur në kundërshtim me neni 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se “Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përbarimi..”

Gjykata e shkallës së parë gjen se përkundër kësaj, Përbaruesi Privat si organ përbarues në këtë çështje përbarimore, nuk ka evituar të metat në fjalë, obligim ligjor ky i përcaktuar me nenin 38, par.2 me të cilin parashihet se “Në rast se propozimi për përbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”.

Tutje në anën tjetër, Gjykata e shkallës së parë konstaton se nga përmbajtja e këtij dokumenti, rezulton se e njëjta nuk është pranuar asnjëherë nga debitori, pasi që tek pranuesi i faturës mungon nënshkrimi dhe vula e debitorit, e si rezultat i kësaj, dokumentit të tillë i mungon elementi i debitorit, si një nga elementet kumulative të përcaktuara me nenin 29, par.3 të LPP-së me të cilin parashihet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.

Andaj në këtë drejtim, referuar nenit 43, par.4 të LPP-së i cili përcakton se “Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrit të përbarueshmërisë së nxjerrë nga përbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përbarim nga përbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim” Gjykata gjeti se Urdhri Përbarimor P.nr. 102/23 i datës 28.04.2023 është nxjerrë pa plotësimin e kushteve për lejimin e përbarimit, pasi që propozimi për përbarim bazohet në një dokument kopje, dhe i cili dokument nuk është pranuar asnjëherë nga debitori.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, gjen se sipas shkresave të lëndës, pala kreditore propozimit të saj për përmbarrim ia ka bashkangjitur faturën me nr.17/2022 e datës 02.11.2023, kemi të bëjmë me një dokument kopje i cili nuk është i nënshkruar e as i pranuar nga debitori, e në rastin konkret fatura nuk paraqitet si dokument i besueshëm pasi që nuk janë plotësuar kushtet nga neni 27 i LPP-së.

Tutje, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarrim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarrim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, pasi që e të njëjtat nuk janë nënshkruar nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarrimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranohet edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejt se fatura si dokument i besueshëm, mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarrimi nuk është e nënshkruar nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht e njëjta nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm për përmbarrim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 21 të LPP-së, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Po ashtu, kjo gjykate vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga fatura respektive , në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përmbarrim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhoma e shkallës së dytë**

**K.DH.SH.II.nr.740/24, me datë 28.05.2024**

**Gjyqtarja,**

**Saranda Bogaj Sheremeti**